Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0782

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani si kryetare, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi si anëtar, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "HARSTGroup" Sh.P.K. të datës 11.10.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 22.09.2023 të Autoritetit Kontraktues - SpitaliRegjionalPrizrenlidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtjadhe renovimi i objekteve spitalore" me numër të prokurimit 70010-23-1324-2-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 01.12.2023 merr këtë:

Vendim

I. Aprovohet si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "HARST Group" Sh.P.K. me nr. 2023/0782 e datës 11.10.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 22.09.2023 të Autoritetit Kontraktues - Spitali Regjional Prizrenlidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve spitalore" me numër të prokurimit 70010-23-1324-2-1-1.

II. AnulohetNjoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 22.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

III. Detyrohet Autoriteti Kontraktues - Spitali Regjional Prizrenpër zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.

IV. Lejohetkthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës së asnkesës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Spitali Regjional Prizren në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 24.02.2023ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve spitalore"me nr. të prokurimit 70010-23-1324-2-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për shërbimdhe me vlerë të parashikuar të kontratës 600,000.00€.

Me datë 22.09.2023Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomikHARST Group" Sh.P.K.

Me 26.09.2023,OE ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 02.10.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me 11.10.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/0782.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:

Pretendimi 1- "Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar vendimin e PSH nr.2023-0388 të OSHP për arsye që nuk kan kërkuar sqarime për qmime abnormalisht të ulëta kompanisë të rekomanduar për kontratë, mirëpo ka rekomanduar përsëri GOE të njëjtë pa kërkuar sqarime lidhur me qmimet abnormalish të ulëta, citoj konkluzen e ekspertiti dhe PSH nr.2023-0388. Ky GOE është i papërgjegjshëm për faktin që ka disa qmime manipulative me qmime njësi 1 euro, ku evidentojm vetëm disa nga pozicionet me qmim njësi 1 Euro: Pos 39 Furnizimi dhe Montimi i **panelave Alumini.** Çmimi per m2 ka ofertuar **1€/m2** Pos 45 Furnizimi dhe Montimi i te **derës se Blinduar**. Çmimi për copë ka ofruar **1€/copa** Pos 6 Furnizimi dhe Montimi i **Radiatorit.** Çmimi per m2 ka ofertuar 0.55 €/m2. Bazuar në këto çmime të ofertuar nga GOE i rekomanduar jo vetëm që janë ab normalisht të ulëta, por edhe janë Çmime komplet manipulative, pasi që me këto çmime nuk mund të blen 1m2 varak(foli) alumini e mos të flasim Panel Alumini, apo me 1 € nuk mund të blen cilindrin e derës, e mos të flasim komplet derën e Blinduar, apo me 0.55€/m2 nuk mundet të blen një ventil të radiatorit e mos të flasim që mund të blenë 1m2 radiator me 0.55€/m2. Supozojm që AK duke e ditur mirë që GOE ka qmime manipulative a normalisht të ulëta, nuk ka kërkuar sqarime për Çmime abnromalisht të ulëta te GOE i rekomanduar, mirpo vetëm kozerciumit tonë, ku për disa pozicione që janë konsideruar të konzerciumi i jonë abnormalish të ulëta, janë shumë më të larta se qmimet po në këto pozicionet te GEO i rekomanduar. Andaj bazuar në ekspertizën nr 2023-0388 dhe Vendimin e PSH nr. 2023-0388, konsiderojm që AK ju ka shmangur konkluzioneve dhe pretendimeve të bazuar për GOE të rekomanduar për kontratë, duke kërkuar sqarime vetëm nga konzerciumi i jone lidhur me qmime abnormalisht të ulëta, duke ju shmangur eliminimin e GOE të rekomanduar pasi që ka pas qmime ultra të ulëta, manipuluese dhe abnormalisht të ulëta".

Pretendimi 2 - "Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar vendimin e PSH nr.2023-0388 të OSHP edhe për faktin që kompania e cila përsëri është rekomanduar për kontratë është konsideruar si e papërgjegjshëm për disa pika, andaj veprimi i AK lidhur me vendimi për rekomandim të GOE të njejtë, supozojmë që ka të bëjë me mos përfillje dhe mos respektim të Panelit Shqyrtues të OSHP, dhe si i tillë ky vendim lidhur me rekomandim të GOE të njejtë për kontratë është në kundërshtim me LPP dhe Vendimin PSH nr. 2023-0388, pasi që GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka të prezantuar Inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë të certifikuar me AME, mirpo ka të prezantuar Bachelor të diplomuar të ndërtimtarisë që nuk është në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Edhe pse AK ka kërkuar sqarime të GOE të rekomanduar për kontrat se të sqarohet evidenca që kanë diplomë të masterit për këtë inxhinier, mirëpo GOE nuk ka dërguar sqarimet sipas kërkesës dhe pa dërguar prova që ka diplomë të Masterit ka potencu kinse është diploma dhe përvoja është sipas DT. Sqarojm kërkesa në DT tek Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 2 pika 2.3 2.3 Nje inxhinier i diplomuar i ndertimtarisë drejtimi hidroteknike me 5 vite pervoje pune pas diplomimit I certifikuar ne AME (Agjensioni per menagjimin e emergjencav) dhe te kete trajnim ne sistemin e shendetit dhe sigurise ne pune. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Për stafin nga pika 2.2 deri 2.6 OE të ofroj dëshmi kopjen e diplomës universitare të noterizuar nga origjinali (noterizimi të mos jetë më i vjetër se 30 ditë nga data e njoftimit për kontratë dhe te jete i noterizuar nga vete i angazhuari...). Andaj bazuar edhe në faktin që ky GOE i cili u rekomandua për kontratë, do të duhej eliminuar pasi që nuk ka dërguar diplomë të masterit konform kërkesës së DT, po ashtu konsiderojm që ky GOE duhet të futet në listë të zezë për arsye të dhënave të rrejshme në CV e prezentuar të inxhinierit".

Pretendimi 3 - "Autoriteti Kontraktues lidhur me arsyetimin për eliminim të konzerciumit tonë lidhur me qmime abnormalisht të ulëta dhe abnormalisht të larta, edhe pse ne kemi bërë sqarime për të gjitha pozicionet veq e veq prejardhjen e çmimit me gjithësejt 66 faqe lidhur me sqarime se si është fituar qmimi duke paraqitur koston e materialit, koston e fuqisë puntore, koston e skeleris, kostone transportit dhe fitimin e parapara, AK na kan eliminuar pa asnjë koment se cili çmimi nuk ka qenë i mirëqen apo cila prejardhje e qmimit nuk është në përputhje me çmimin e tregut. Gjithashtu as që janë shkarkuar nga e- prokurimi dëshmitë lidhur me arsyetimin e qmimit. Konsiderojmë që kërkesa për sqarime të qimeve ka qenë vetëm sa për të dhënë një arsye për ta shpërfillur Vendimin e PSH, ndërsa nuk është kërkuar sqarime tek GOE i rekomanduar për kontratë ku ka qenë e precizuar ne Vendim të PSH nr 2023-0388 të kërkohet arsyeshmëri e çmimeve për çmime ab normalisht të ulëta që sqaruam në pretendimin 1. Edhe pse AK në sqarimet e kërkuar ka evidentuar me tepër se gjysmën e paramases kinse disa qmime janë abnormalish të ulëta e disa ka konsideruar të larta, ne kemi sqaruar veq e veq për secilin 66 faqe, po ashtu në këto qmime që janë konsideruar abnormalish të ulta vetë GOE i rekomanduar për kontrat disa nga këto qmime i ka shumë më lirë se oferta janë të cilat janë konsideruar abnormalish të ulëta, si dhe disa pozicione tjera të cilat janë konsideruar shumë të larta për neve, po ashtu GOE i rekomanduar për kontrat i ka shumë më të larta se oferta e jonë".

Pretendimi 4 - "Autoriteti Kontraktues lidhur me arsyetimin për eliminimin të konzerciumit tonë lidhur me kinse nuk kemi dëshmi të mjaftueshme për mbështetje nga banka apo nuk kemi mjete në llogari në vlerë 60 mije euro, përpos që nuk është ky pretendim i qëndrueshëm, supozojm që kemi të bëjmë edhe me keqpërdorim të detyrës zyrtare, pasi që ne si kompani kemi pasur të dorzuar me ofertë mbështetjen nga banka në vlerë 100 mije euro, po ashtu në sqarimet e kërkuar nga AK kemi dorzuar edhe raport nga banka që me datë 14.04.2023 kemi pasur mjete financiar vetëm në Procredit Bank 104,676.30 euro, po ashtu kemi dërguar edhe letër përkrahje nga banka BKT e cila ka konfirmuar mbështetje nga banka që nuk ka kushtëzime për qasje në kredi deri në vlerë 100 mije euro. Konsiderojm që kjo arsye eliminuese është e pabazuar dhe e pa qëndrueshëm, pasi që konzerciumi jonë ka mjete monetare shumë më tepër se sa janë kërkuar dhe mbështetje bankare mund të kemi deri në 500 mije euro në rast që është e nevojshme".

Pretendimi 5 - "Autoriteti Kontraktues po ashtu e kanë kosideruar që OE më i shtrejtë se kompania jonë, si të përgjegjshëm, ku ky OE e ka letër përkrahjen të ngjashme me atë të cilën kemi dorzuar në ofertë ku potencohet që në rast kërkese për mbështetje financiare nga banka për këtë projekt, banka do ta shqyrtojë financimin e tij, dhe në këtë rast AK do të duhejt të trajtonte të gjithë Ofertuesit në mënyrë të barabart dhe të mos bëntë diskriminim. Ofertuesi më i liri në këtë tender OE Al...s është i eliminuar dhe është pa interes material pasi që nuk ka paraqitur ankes. Gjitashtu OE më shtrejt se ne - ofertuesi 4 OE Term...m është pa interes material pasi që në Ankesen nr.2023-0388 dhe në kërkesat për rishqyrtim kemi potencuar që është i papërgjegjshëm dhe është pajtuar pasi që nuk ka paraqit kërkes për rishqyrtim dhe është pajtuar, për mangësitë që i ka lidhur me staf profesional, për të cilat nuk po zgjerohemi në këtë fazë. Andaj bazuar në ato që cekem më sipër, supozojmë që arsyet eliminuese janë të pabazuara lidhur me arsyet eliminuese të kompanisë tonë, pasi që janë dhënë sqarimet e nevojshme dhe nuk kemi ndonjë saktësim se cila nuk e plotëson, po ashtu AK as që kan qenë të interesuar të merreni me sqarime pasi që është fakt dëshmia nga e-prokurimi që as që janë shkarkuar nga e- prokurimi dëshmitë e dërguar për sqarime".

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 69 dhe 72 të LPP. Operatori

ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues që të miratohet ankesa ashtu që të kthehet lënda në Rivlerësim.

Autoriteti kontraktues në vendimin e datës 02.10.2023 AK ka pohuar se Oe ankues në ofertën e tij ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta dhe ab-normalisht të larta, kurse po ashtu i njejti nuk ka plotësuar edhe kriterin tek kapaciteti ekonomik dhe financiar OE duhet të dëshmoj se qarkullimi vjetor i tij duhet të jetë jo më pak se 1,200.000.00 euro kurse udhëheqësi ti ketë së paku 60% të shumës së qarkullimit vjetor për 3 vitet e fundit, ankuesi nuk e ka plotësuar kërkesën për kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës , mjete të gatshme në bankë ose qasje në kredi të pakushtëzuar prej së paku 10% e vlerës së parashikuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 20.10.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 30.10.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*lënda të trajtohet si çështje e gjykuar res juridikata sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas vendimit paraprak të PSH.OSHP nr. 2023/0388 i dt. 12.06.2023 dhe procedura të kthehet në Rivlerësim*". AK nuk është deklaruar fare lidhur me raportin kurse OE ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

***Eksperti shqyrtues l*idhur me pretendimin e parë (I) ankimor,** *ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "Eksperti Shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit nga PSH (OSHP) është nxjerr 1 (një) Vendim me numër: OSHP: 2023/0388 i publikuar me datën: 12.06.203 që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të respektohen dispozitat ligjore, neni 41.6 i Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 sipas të cilës Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP Shkresa standarde për tenderët jo normalisht të ulët. Bazuar në neni 16 (Rastet e Unifikuara) pra janë përsëritur pretendimet ankimore të njëjta për palët në procedurë lidhur me lidhur me këto pretendime ankimore, ku objekt i kontekstit dhe palët janë të njëjta, për rastet ku janë shqyrtuar më parë si çështje të gjykuara res judikata sipas nenit 105.2.16 të LPP , andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues. Gjithë ashtu eksperti shqyrtues sqaron si në vijim: është përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht komisionit të vlerësimit - ZPP që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP".*

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor, *eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "Eksperti Shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit nga PSH (OSHP) është nxjerr 1 (një) Vendim me numër: OSHP: 2023/0388 i publikuar me datën: 12.06.203 që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të respektohen dispozitat ligjore, 6, 7, 9, 59, 60, 69, 72 të LPP. Bazuar në neni 16 (Rastet e Unifikuara) pra janë përsëritur pretendimet ankimore të njëjta për palët në procedurë lidhur*

me lidhur me këto pretendime ankimore, ku objekt i kontekstit dhe palët janë të njëjta, për rastet ku janë shqyrtuar më parë si çështje të gjykuara res judikata sipas nenit 105.2.16 të LPP, andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues. Gjithë ashtu eksperti shqyrtues sqaron si në vijim: është përgjegjësi dhe në diskrecion të AK respektivisht komisionit të vlerësimit - ZPP që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP".

Lidhur me pretendimin e tretë (III) ankimor,*eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "Eksperti Shqyrtues sqaron, duke u bazuar mbi bazën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë sipas vendimit OSHP: 2023/0388 i publikuar me datën: 12.06.203, lidhur me çmime a normalisht apo ab normalisht ulta apo të larta. AK sipas vendimit të larë përmendur, AK duhet të kërkoj sqarime shtesë/arsyeshmëri të çmimeve për dy grupet e operatoreve ekonomik dhe të respektohen dispozitat ligjore neni 7 i LPP si dhe neni 41.6 i RRPP sipas të cilës Në rast se një tender(apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi)duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP - Shkresa standarde për tenderët jo normalisht të ulët. Bazuar në neni 16 (Rastet e Unifikuara) pra janë përsëritur pretendimet ankimore të njëjta për palët në procedurë lidhur me lidhur me këto pretendime ankimore, ku objekt i kontekstit dhe palët janë të njëjta, për rastet ku janë shqyrtuar më parë si çështje të gjykuara res judikata sipas nenit 105.2.16 të LPP, andaj nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues. Gjithë ashtu eksperti shqyrtues sqaron si në vijim: është përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues respektivisht komisionit të vlerësimit - ZPP që procesi i vlerësimit të behet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP".*

Lidhur me pretendimin e katërt (IV) dhe të pestë (V) ankimor,*eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "Sipas dosjes së tenderit dhe kërkesës në FDT, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2, Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre vite të fundit financiare duhet te jetë jo më pak se 1,200.000.00 Euro. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar të qarkullimit vjetor për 3 vitet e fundit. Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme n bankë ose qasje në kredi te pakushtëzuar në vlerë prej së paku 10% e vlerës se parashikuar te buxhetit. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Raporti bankar (vërtetim) apo ndonjë dëshmi tjetër zyrtare financiare qe dëshmon qarkullimin financiare për tri vitet të fundit. Dokumenti të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar që dëshmon se OE i ka mjetet financiare në dispozicion lidhur për këtë projekt. Eksperti Shqyrtues sqaron, duke u bazuar mbi bazën e fakteve dhe argumenteve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurimi, OE ankues në ofertën e tije fillestare ka dorëzuar Letër mbështetje nga banka BKT dhe me datën: 14.08.2023 ka ofruar një sqarim po ashtu nga banka në fjalë citoj (letrën të lëshuar nga Banka), Sqarim: Letër përkrahja e datës 12.04.2023 është format i letër përkrahjeve për produktet e tenderuese publike dhe shqyrtimi i financimit është procedurë e brendshme e bankës – Dëshirojmë t'ju informojmë se Banka merr në konsideratë me interes të veçantë çdo kërkesë financiare që lidhet me qëllimin e përmendur më lartë. Bazuar në letër përkrahjet të cilat i ka lëshuar banka dhe në letrën sqaruese të cilën e ka dhen banka me dt. 14.08.2023 AK ka mundur të kërkoj sqarime nga banka konfomrm nenit 59 pika 2 dhe 72 i LPP pretendim ankimor*

është pjesërisht i bazuar".

-Konstatime e panelit Shqyrtues-

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdes profesional i ka administruar dhe vlerësuar të gjitha provat në shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në harmoni të plotë me dispozitën e nenit 59 të LPP dhe vendimin e OSHP Nr 388/2023, përderisa nuk i ka përdorur apo zbatuar me kohë dhe gjatë rrjedhës së aktivitetit kompetencat e tij në vështrim të paragrafit 2, të dispozitës së cituar sipas së cilës Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Nga pikëpamja e Panelit e po ashtu edhe në kuptim të hulumtimeve të eksperti shqyrtues mund të konstatohet se, informacionet shtesë kanë qenë në fakt të nevojshme që për hire të vlerës së tenderit, rëndësisë dhe qëllimit të prokurimit të vërtetohen në mënyrë të pakontestueshme faktet përkitazi me çmimet e ofruara nga Oe i rekomanduar për kontratë të cilat gjatë rjedhjes së kësaj procedure janë kontestuar si çmime ab-normalisht të ulëta.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP lidhur me nenin 97 par. h) të RRPP dhe në kundërshtim edhe me vendimin Nr.388/2023.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se pretendimi i parë, pretendimi i dytë dhe pretendimi i tretë ankimor lidhur me këtë aktivitet të prokurimit janë shqyrtuar përmes vendimit të Panelit Shqyrtues me shenjën OSHP:2023/0388 të datës 27.07.2023. Prandaj Paneli Shqyrtues qëndron prapa konstatimeve në vendimin paraprak lidhur me këto pretendime në kuptim të nenin 16 të Rregullores së Punës së OSHP pasi që pretendimet ankimore janë të njëjta për palët në procedurë lidhur me lidhur me këto pretendime ankimore, ku objekt i kontekstit dhe palët janë të njëjta, për rastet ku janë shqyrtuar më parë si çështje të gjykuara res judikata sipas nenit 105 par. 2 nënpar. 16 të LPP. Me këtë rast Paneli Shqyrtues shton se pajtohet me vlerësimin e ekspertit shqyrtues ku thuhet se "eksperti shqyrtues sqaron si në vijim: është përgjegjësi dhe në diskrecion të AK respektivisht ko misionit të vlerësimit -
ZPP që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet në harmoni të plotë me dispozi tat ligjore të LPP. AK sipas vendimit të larë përmendur, AK duhet të kërkoj sqarime shtesë/arsyeshmëri të çmimeve për dy grupet e operatoreve ekonomik dhe të respektohen dispozitat ligjore neni 7 i LPP si dhe neni 41.6 i RRPP sipas të cilës Në rast se një tender(apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi)duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP - Shkresa standarde për tenderët jo normalisht të ulët.

Sa i përket pretendimit ankimor të katërt dhe të pestë, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë vlerësimeve të ekspertit shqyrtues ku ndër të tjera thuhet se "Bazuar në letër përkrahjet të cilat i ka lëshuar banka dhe në letrën sqaruese të cilën e ka dhënë banka me dt. 14.08.2023, Autoriteti Kontraktues ka mundur të kërkoj sqarime nga banka sipas nenit 59 par 2 dhe 72 të LPP".

Andaj duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës sipas gjykimit të pavarur të panelit duke u bazuar edhe në LPP dhe RRPP, UPP, ky aktivitet duhet të kthehet sërish në rivlerësim dhe duhet obliguar AK që të zbatoj në përpikëri dy rekomandimet e ekspertëve shqyrtues Nr rendor 388/2023 dhe 782/2023 aprovuar andaj duhet të kërkoj sqarime shtesë nga Operatorët Ekonomik të tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet në zbatim të nenit 1,6,7 të LPP-së. Përmes nenit 1 të LPP përcaktohet se "Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese...". Përmes nenit 6 të LPP përcaktohet se "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit". Paneli Shqyrtues bazuar në të lartcekurat thekson që Autoriteti Kontraktues me qëllim të vërtetimit të saktë dhe të drejtë të ofertave duhet të kërkoj edhe sqarime shtesë nga ofertuesit në kuptim të nenit 72 të LPP dhe lidhur me nenin 38 paragrafin 38.1 të RRPP. Përmes nenit 72 të LPP përcaktohet se "Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji" kurse parg 3 përcaktohet "Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive". Ndërsa përmes nenit 38 paragrafit 38.1 të RRPP përcaktohet se "Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK "Kërkesë për sqarim të tenderit". Kërkesa për sqarim dhe përgjigja bëhen përmes platformës elektronike" duke siguruar çdo provë relevante dhe të argumentuar në relacion çmime të tregut dhe çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar meqenëse kjo kërkesë ka qenë e parashtruar edhe sipas vendimit paraprak të OSHP 388/23.

Me këtë rast Paneli Shqyrtues thekson faktin se vendimet e OSHP duhet të respektohen në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Në të kundërtën, mosrespektimi i vendimeve të OSHP përbën shkelje të rëndë ligjore në kuptim të nenit 97 paragrafit h) të RRPP dhe mund të sanksionohet sipas ligjit në fuqi për prokurimin publik si dhe legjislacionit përkatës sekondar. Prandaj Paneli Shqyrtues i tërheq vërejtjen përfundimtare Autoritetit Kontraktues për respektimin pa përjashtim të dispozitave të LPP dhe RRPP dhe vendimeve të OSHP-së sepse në të kundërtën OSHP do të veprojë sipas autorizimeve bazuar në nenit 105 të LPP duke iniciuar procedurën ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit në kuptim të nenit 25 dhe po ashtu të imponoj gjobë ndaj Autoritetin kontraktues në kuptim të nenit 131 të LPP-së.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Spitali egjional rizren të datës 22.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve spitalore" me numër të prokurimit 70010-23-1324-2-1-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së

ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **SPITALI REGJIONAL - PRIZREN**
- OE - **HARST Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: